

**AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQËRISË ME ORTAK TË VETËM**

“ENVER 66” SHPK

*KAPITULLI I
KRIJIMI, FORMA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, EMËRTIMI, SELIA*

**NENI 1
KRIJIMI I SHOQËRISË**

1. Sot më datë 29/04/2023 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “ENVER 66” shpk, (Në vijim referuar si “Shoqëria”).
2. Shoqëria është person juridik shqiptar dhe funksionon në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar.
3. Shoqëria gjëzon të drejta si person juridik shqiptar që prej datës në të cilën organet kompetente kanë dhënë aprovimin për themelimin e saj.
4. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

**NENI 2
FORMA E SHOQËRISË**

1. Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë që Ortaku i vetëm i kësaj shoqërie nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.
2. Veprimitaria e shoqërisë do të rregullohet sipas radhës nga dispozitat e këtij statuti dhe dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, për aq kohë sa dispozitat e këtij statuti nuk vijnë në kundërshtim me ligjin e mësipërm.


**NENI 3
EMËRTIMI**

1. Emërtimi i shoqërisë është “ENVER 66” sh.p.k. Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet sh.p.k.

**NENI 4
SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria e ka selinë në qytetin e Fierit, në adresën: Lagjja 1 Maj, Rr. Çamëria, Pallati Kupola, Shkalla nr. 1, Hyrja nr. 28, Fier. E-mail enverlamaj1966@gmail.com dhe cel. 0697334973.

1. Përveç veprimitarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, degëve, agjensive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



2. Selia mund të transferohet në çdo vend tjeter brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një Vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

NENI 5 **KOHËZGJATJA**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat.
2. Në përputhje më këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj në çdo kohë e kur e shët të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 6 **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :
 - Ndërtime civile, studimi, projektimi dhe mirëmbajtja e tyre.
 - Ndërtime rrugë, ujesjellësa, vepra ujitëse, rezervuarë diga.
 - Ndërtime sisteme elektrike, instalime, parqe fotovoltaikë.
 - Tregëti me shumicë dhe pakicë.
 - Import – Eksport.
2. Përveç aktiviteteve të parashikuara më lart, në veprimtarinë e Shoqërisë do të përfshihet çdo veprimtar tjetër që nga Ortaku do të konsiderohet e nevojshme dhe e përshtatshme për përbushur objektin e Shoqërisë dhe që nuk ndalohet nga ligji.
3. Aktivitetet e Shoqërisë, për të cilat kërkohet paraprakisht një leje, licencë, autorizim apo ndonjë akt tjetër miratues, do të ushtrohen pasi të jete marrë akti në fjalë.


NENI 7 **EMBLEMA, VULA**

1. Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga Asambleja e Ortakut të Vetëm dhe nga administratori i shoqërisë.
2. Forma dhe përmasa e vulës do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakut të Vetëm pas rregjistrimit te saj, në përputhje me rregullat e legjisacionit shqiptar. Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnë emblemën dhe vulën e saj.

KAPITULLI II **KAPITALI THEMELTAR, ORTAKU, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE**

NENI 8 **KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 100 000 (njëqind mijë) Lekë. Kontributi i Ortakut përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.



2. Pjesëmarrja e Ortakut në Shoqëri është në raport me kontributin e tij dhe vlera nominale e kuotës së tij, e cila llogaritet në raport me këtë kontribut, është 100 000 lekë; e paraqitur në mënyrë të përbledhur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emri i Ortakut	Kuota	Vlera	Përqindja %
1.	Enver Lamaj	1	100 000 lekë	100
TOTALI		1	100 000 lekë	100

3. Ai mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm sipas normave të fushës në fuqi.
 4. Kapitali është shlyer tërësisht.

NENI 9 **ORTAKU I VETËM DHE KUOTAT**

1. Shoqëria përbëhet nga një Ortak i Vetëm, me të dhënat e mëposhtme:

- Enver Lamaj, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar, i lindur më 06/09/1966 në Mollaj, FIER, banues në Lgj. 1 Maj, Rr. Çamëria, Pallati Kupola, Shkalla nr. 1, Hyrja nr. 28, Fier, mbajtës i kartës me nr. 037702808 dhe nr. personal G60506009O, nr. Cel 0697334973, i cili zoteron 100 % të kuotave.
2. Ortaku i Vetëm i shoqërisë zoteron një kuotë në masën 100 % me vlerë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

NENI 10 **MËNYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a. Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b. Shitblerjes;
 - c. Trashëgimisë;
 - d. Dhurimit;
 - e. Çdo mënyre tjetër parashikuar në ligj.
2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata.
3. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përben kusht per vlefshmérinë apo regjistrimin e kontratës.
4. Me përashtim të rasteve kur parashikohet shprehimi i ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga

kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

5. Kuotat që shiten kanë vlerën fillestare të rregjistrimit të kapitalit fillestar, nëse shoqëria deri në momentin e fillimit të procedures së shitjes nuk ka bërë rritje kapitali sipas ligjit dhe të rregjistruar në QKB, me përashtim të rastit kur palët bien dakort për një vlerë më të lartë.
6. Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlgimin e shprehur me anë të Vendimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

NENI 11

PASOJAT E KALIMIT TË KUOTAVE, PJESTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE

1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e përfiton atë, përgjigjen në mënyre solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që trjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të nenit 74 të Ligjit Për shoqëritë tregtare.
2. Shoqëria realizon kalimin e kuotës, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit”.

KAPITULLI III MARRËDHENIET NDËRMJET SHOQËRISË DHE ORTAKUT

NENI 12


SHPËRNDARJA E FITIMEVE

1. Ortaku ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare te shoqërise që janë miratuar nga një ekspert kontabël i miratuar dhe nga Asambleja e Ortakut të Vetëm me Vendim. Shoqëria mund të mos ndajë fitim edhe kur realizon fitim, nëse mbledhja e asamblesë ka vendosur për këtë qëllim.
2. Administratori i shoqërisë në rastin e shpërndarjes së fitimit duhet që dokumentin përkates që autorizon strukturen përkatese për kalimin e fitimeve tek Ortaku i Vetëm i shoqërisë, ta shoqërojë me Vendimin përkates të Asamblese.

NENI 13

KUFIZIMET E SHPËRNDARJES, ÇERTIFIKATA E AFTËSISE PAGUESE, PËRGJEGJESITË

1. Shoqëria mund të shpërndajë fitimin për Ortakun e Vetëm, vetëm nëse pas pagimit të fitimit:
 - a. Aktivet e shoqërise mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12-muajve në vazhdim.
2. Administratori lëshon një çertifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e fitimit përmbysh kërkesat e paragratit të parë të këtij nenj, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e fitimit nuk i përmbysh këto kriterë, administratori nuk mund të lëshojë këtë çertifikatë.



3. Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikates së aftësisë paguese.
4. Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjet personalisht përparrë shoqërisë për kthimin e fitimit të shpërndarë.
5. Ortaku, që ka marrë nga shoqëria fitim, përgjigjet personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e tij, pavarësisht lëshimit të certifikatës, nëse ka pasur dijeni për gjëndjen e paaftesise paguese të shoqërise sipas paragrafit të parë të këtij nenit.

KAPITULLI IV
ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:


1. Asambleja e Ortakut të Vetëm

2. Administratori

ASAMBLEJA E ORTAKUT TË VETËM

NENI 14
TE DREJTAT DHE DETYRAT

1. Asambleja e Ortakut te Vetëm merr Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë. Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kryesisht, por pa u kufizuar, çështjet e mëposhtme :
 - a) Përcaktimin dhe mbikëqyrjen e politikave tregtare të Shoqërise;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve si dhe përcaktimin e shpërbimit për ta;
 - d) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërbimit për ta;
 - e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - g) Riorganizimin, prishjen dhe likuidimin e shoqërise ;
 - h) Miratimin e strukturës së shoqërisë dhe nivelet e pagave për vend pune;
 - i) Investime afatshkurtra dhe afatgjata;
 - j) Miratimin e marrjes së kredive bankare;
 - k) Shndërrimin e formës së shoqërisë dhe/ose bashkimin me shoqëri të tjera, apo pjesëmarrjen në shoqëri apo grupe shoqërish;
 - l) Miratimin e rregulloreve të ndryshme të punës si dhe rregulloreve të tjera që në thelb kanë të bëjnë me procese të rendësishme të veprimtarise së shoqërise ;
 - m) Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - n) Çështje të tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar apo ky Statut.
2. Duhen regjistruar në veçanti ne Qendrën Kombëtare të Biznesit, por pa u kufizuar në to, vendimet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm për :
 - a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve ;
 - c) Investime;
 - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
 - e) Vendime të tjera që Asambleja e Ortakut të Vetëm vlerëson se duhen rregjistruar.



3. Të gjitha Vendimet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm ruhen në një regjistr tё veçantë, sipas numrit dhe datës. Administratori përgjigjet për rregullsinë e rregjistrat. Vendimet e paregjistruar në Registrin e Vendimeve janë absolutisht tё pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë tё tretit, që ka fituar tё drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë tё rrrethanave tё qarta nuk mund tё kishte pasur dijeni për tё.

ADMINISTRATORI

NENI 15

EMËRIMI, SHKARKIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

1. Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë tё shoqërisë. Afati i emërimit nuk mund tё jetë më i gjatë se 5 (pesë) vjet, me tё drejtë ripërtëritjeje. Asambleja e Ortakut tё Vetëm merr vendim tё posaçem për riemërimin e Administratorit pas periudhës së emërimit tё parë.
2. Administratori do tё përfaqësojë Shoqërinë dhe do tё jetë ligjërisht përgjegjës për aktivitetet e Shoqërisë. Administratori do tё menaxhojë dhe drejtojë veprimitarën e përditshme tё Shoqërisë duke siguruar që menaxhimi i Shoqërisë tё bëhet në mënyrë tё ligjshme dhe në interes tё Shoqërisë. Duke qenë përfaqësuesi ligor i Shoqërisë, Administratori ka tё drejtën tё nënshkruajë aktet dhe dokumentat e Shoqërisë, përfshirë hartimin e tё gjitha vendimeve tё Shoqërisë.
3. Caktimi i Administratorit bëhet nga ky statut për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me tё drejtë riemërimi nga Ortaku i Vetëm. Administratori i shoqërisë caktohet Ortaku i Vetëm, **Enver Lamaj**, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për tё vepruar, i lindur më 06/09/1966 në Mollaj, FIER, banues në Lgj. 1 Maj, Rr. Çamëria, Pallati Kupola, Shkalla nr. 1, Hyrja nr. 28, Fier, mbajtës i kartës me nr. 037702808 dhe nr. personal G605060090.
4. Administratori ka tё drejtë ë detyrohet tё:
 - a) kryejë tё gjitha veprimet e administrimit tё veprimitarisë tregtare tё shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare në marredhenie me te tretet, personalisht ose me përfaqësim, tek palët e treta, institucionale apo entitetë publike ose private;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e tё rregullt tё dokumenteve dhe tё librave kontabël tё shoqërisë;
 - d) mbajë një rregjister tё veçantë ku tё bëjë rregjistrimin e tё gjitha Vendimeve tё Ortakut tё Vetëm.
 - e) lidhë kontratat e punës me punonjësit e shoqërisë;
 - f) mbajë korespondencë tё rregullt me tё tretët, si dhe tё marrë tё gjitha masat që kjo tё jetë e arkivuar në arkivën e shoqërisë;
 - g) përgatitë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve,
 - h) kryejë regjistrimet dhe dërgojë tё dhënat e detyrueshme tё shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare tё Regjistrimit;
 - i) kryejë detyra tё tjera tё përcaktuara në ligj dhe në kete statut.

NENI 16 PËRFAQËSIMI

1. Tagrat e përfaqësimit tё administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare tё Regjistrimit.



- Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- Administratori mund të autorizojë një të tretë, me anë të një prokure të posaçme, për kryerjen e të gjitha kompetencave të përshkruara në nenin 15 të këtij Statuti si dhe për ato kompetenca që i lindin në bazë të Ligjit Tregtar.

NENI 17 SHPËRBLIMI


- Shpërblimit bazë të administratorit mund t'i bëhen shtesa. Shtesat bëhen me vendim të asambleës së Ortakut të Vetëm.
- Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit, gjendjen financiare të shoqërisë dhe të respektojë nivelet minimale të kërkura nga legjislacioni në fuqi.
- Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e Ortakut të Vetëm mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.
- Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 18 VITI FINANCIAR, BILANCI, KONTABILITETI, HUMBJET DHE FITIMET

- Viti finanziar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filuar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të çdo viti. Si përjashtim, viti i parë finanziar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.
- Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakut të Vetëm dhe duhet të përgatitet përt'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së vitit finanziar, pas pagimit të detyrimeve, i kalojnë Ortakut të Vetëm.
- Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe Ortaku do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e vitit finanziar të parë deri ne tre vitet pasardhës.

NENI 19 EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR

- Ortaku mund të emërojë një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.
- Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarës ekonomike-tregtare të Shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrolllet periodike të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe i ka kryer këto duke qenë i ngarkuar nga Ortaku.



3. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të rapportit vjetor, si dhe atë për kontrollot periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë Ortakut për t'i shqyrtuar dhe miratuar mbi bazën e të drejtës së tij vendimmarrëse.

KAPITULLI IV
PRISHJA E SHOQËRISË, LIKUIDIMI

NENI 20
SHKAQET E PRISHJES SE SHOQËRISE


1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
 - b) me përfundimin e procedurave te falimentimit apo në rast të pamjaftueshmerise së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i parealizueshem apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - d) në rastet e pavlefshmerise së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit tregtar;
 - e) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - f) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - g) për çdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Ortakut të Vetëm.
2. Prishja e shoqërise, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara më sipër, vendoset nga Asambleja e Ortakut të Vetëm të shoqërisë.
3. Me Vendimin e Asamblesë së Ortakut të Vetëm, caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë proçedurat e likuidimit.

NENI 21
REGJISTRIMI I SHPERBERJES

1. Administratori ka detyrë të regjistrojë shpërbërjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim.
2. Ne rastin e prishjes së shoqërisë, pavaresisht institucionit që ka marre vendimin, ngarkohet administratori që të kryejë proçedurat deri në përfundim të këtij procesi, për aq kohë sa, kjo dispozite e statutit nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

NENI 22
LIKUIDIMI NE GJENDJEN E AFTESISE PAGUESE

1. Me përashtim të rasteve kur është nisur një proçedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e proçedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare " të ndryshuar.



NENI 23
PROCEDURA E SHNDËRRIMIT

1. Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore me miratimin e Ortakut, nëpërmjet shndërrimit, sipas procedurës së parashikuar në Ligjin Tregtar.
2. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve. Marrëdhënet e brendshme në fushën e menaxhimit dhe administrimit të Shoqërisë midis administratorit, Ortakut, dhe çdo të punësuari në Shoqëri, do të rregullohen me anën e një rregulloreje të miratuar nga Ortaku.
3. Shndërrimi njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me Ligjin Tregtar.

NENI 24
DISPOZITA TRANZITORE DHE TE FUNDIT

1. Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut që lidhet me funksionimin e shoqërisë, zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi në momentin e nënshkrimit të këtij stauti.
2. Në çdo rast kur legjislacioni shqiptar përkatës mund të ndryshojë, ky statut me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, sipas rregullave te përcaktuara mund të ndryshohet, në perputhje me ndryshimet përkatëse të legjislacionit në fuqi.
3. Ky akt themelimi dhe statut hartohet në 3 kopje origjinale, dhe hyn në fuqi për palët nënshkruese nga data e nënshkrimit të tij dhe prodhon efekte ndaj të tretëve nga data e rregjistrimit të tij në QKB.

ORTAKU I VETËM
Enver LAMAJ

